



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2023

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: “**BLERIMI**” sh.p.k me adresë: Elbasan, Shirgjan Mjekes, Fshati Mjekes, Zona Topcias, Rruga Elbasan - Cerrik km 4, prane lumit Shkumbin.

Procedura e prokurimit: “**Procedurë e hapur e thjeshtuar**”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-78547-08-29-2023

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Riparime dhe mirëmbajtje të objekteve arsimore**”, me fond limit: **8.021.311** (tetëmilion e njëzet e njëmijë e treqind e njëmbëdhjetë) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan, dhe me afat për kryerjen e shërbimit 3 muaj nga nenshkrimi i kontrates.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “BLERIMI” sh.p.k me Nipt: J62903384G

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **6.037.786** (gjashtëmilion e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë) **lekë (pa tvsh)**.

2. “INA” Sh.p.k me Nipt: J61814009W

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **6.004.536** (gjashtëmilion e katërmijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) **lekë (pa tvsh)**.

3. “TEA- D” Sh.p.k me Nipt: K32522629L

Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Ofertues të s’kualifikuar ka, operatori ekonomik “TEA-D” Sh.p.k me Nipt: K32522629L për arsyet e mëposhtme:

Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokumentacion ligjor/teknik dhe financiar.

Operatori ekonomi “INA” Sh.p.k me Nipt: J61814009W skualifikohet për arsyet e mëposhtme:

Oferta ekonomike e paraqitur me çmimin total prej **6’004,536** (gjashtëmilion e katërmijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) **lekë pa t.v.sh.**, e paraqitur nga operatori ekonomik **"INA" sh.p.k**, në prokurimin me objekt **“Riparime dhe mirëmbajtje të objekteve arsimore”** me **fond limit** prej **8,021,311** (tetëmilion e njëzet e njëmijë e treqind e njëmbëdhjetë) **lekë pa t.v.sh**, zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Elbasan, rezulton të jetë anomalisht e ulët.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në datën e hapjes së procedurës së prokurimit përpara se të bëjë kualifikimin e ofertës tuaj ka kërkuar me shkrim shpjegime për elemente të veçantë të ofertës tuaj në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja në dijeni e kësaj kërkesë.

Operatori ekonomik ka dorezuar shpjegimet brenda afateve të percaktuara.

Kvo pasi shqyrtoi shpjegimet e operatorit ekonomik ka vendosur ta refuzojë ofertën pasi edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi ajo është e parregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar nenit 93 të ligjit r.162/2020 datë 23.12.2020 «Për Prokurimin Publik», i ndryshuar, KVO konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar anomalisht e ulët nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 285, dt. 19.05.2021. Gjithashtu, KVO gjykon se argumentimi i ofertes anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotesoje kriter kushte kumulative për të dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori

ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndertimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatoreve ekonomike oferta e të cileve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me originalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës dhe mbrojtjen e mjedisit në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. KVO gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik “INA” Sh.p.k , konstatohet se:

Operatori Ekonomik pretendon se ka ekskluzivitet për një sere materialesh dhe pajisjesh por pa dokumentar dhe pa specifikuar fare dhe lidhjen me zerrat konkret të ofertuar. OE pretendon se materialet e nevojshme për instalimet elektrike, hidrosanitare, mbrojtje nga zjarri janë stok në magazine, nderkohe që proceduar në fjalë është një procedure mirembajtje, lysterje me boje të objekteve dhe materialet kryesore të nevojshme janë astar dhe boje dhe ato të permenduara nga OE.

OE ka paraqitur analizat e cmimeve për zerrat përkatës të punimeve ku zeri kryesor i kontratës është 2.404 "Boje hidroplastike" me analizen e hartuar nga OE si më poshtë:

Nr.	EMERTIMI	Njesia	PUNETORI			MATERIAL			Shuma	Shp pl	fitim	totali
			op	çmimi	Vlefta	Sasia	çmimi	Vlefta				
Kodi										8 %	10%	
1	2	3	4	5	6	13	14	15	16	17	18	19
2.404	Boje hidroplastike	m2										
	Sp+p	op	0.36	185	67							
	Sigurime shoqerore 16.7 %	leke	66.6	0.167	11							
	Astar (vinovil)	kg				0.15	170	26				
	Boje hidroplastike importi	kg				0.2	190	38				
	Te ndryshme 10 %	leke				63.5	0.1	6				

	Shuma				78			70	148	12	15	174
--	--------------	--	--	--	-----------	--	--	-----------	------------	----	----	------------

Nderkohe qe analiza perkatese sipas Vendim nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndertimit dhe të analizave teknike të tyre" eshte:

Nr.	EMERTIMI	Njesia	PUNETORI			MATERIAL			Shuma	Shp pl	fitim	totali
			op	çmimi	Vlefta	Sasia	çmimi	Vlefta				
Kodi										8 %	10%	
1	2	3	4	5	6	13	14	15	16	17	18	19
2.404	Boje hidroplastike	m2										
	Sp+p	op	0.16	225	36							
	Sigurime shoqerore 16.7 %	leke	36.0	0.167	6							
	Astar (vinovil)	kg				0.15	136	20				
	Boje hidroplastike importi	kg				0.2	171	34				
	Te ndryshme 10 %	leke				54.57	0.1	5				
	Shuma				42			60	102	8	10	120

Nga krahasimi i dy analizave verehet se OE ekonomik ka ulur ne menyre ne ndjeshme oret e punes per zerin e lyerjes. Duke qene se kjo ulje eshte mbi 55 % e oreve te punes se parashikuara ne analizen perkatese sipas Vendim r. 629, date 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të mimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" ka rezultuar per rrjedhoje qe oferta te jete anomalisht e ulet. KVO referuar dhe bazuar ne shpjegimet e OE nuk veren se ai ndodhet perpara rastit qe ofron nje metode zbatimi/ndertimit ekskulstive apo zgjidhje teknike veçante apo dipsonimin e ndonje pajisje/makinerie inovative he/ose ndonje kusht favorizues te jashtëzakonshëm nepermjet te cilave te justifikojte uljen e oreve te punes ne kete mase. KVO referuar shpjegimeve te dhena nga OE gjykon se ai ka deshtuar ne argumentimin teknik dhe ekonomik te ofertes se tij.

KVO gjykon se vleresimi i ofertave anomalisht te uleta lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë nje ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. KVO gjykon se risku qe shfaqet në rast se nje ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku per moskryerjen e sherbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e sherbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të

moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

Sa me sipër KVO vendos ta refuzojë ofertën, pasi edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e regullt në të gjitha elementet e saj.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“BLERIMI” sh.p.k me Nipt: J62903384G** me adresë: Elbasan, Shirgjan Mjekes, Fshati Mjekes, Zona Topcias, Rruga Elbasan - Cerrik km 4, pranë lumit Shkumbin, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **6.037.786** (gjashtëmilion e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë) **lekë (pa tvsh)**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor Bashkia Elbasan me adresë: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë):

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
Zv.Kryetari
Aulona Bylykbashi**